# DËSHMI ARKIVI

**A-449630**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Dënimet në Hagë, reagon kryediplomati britanik: Krenarë me rolin tonë në Kosovë vitin 1999. Vendimi i sotëm nuk është mbi shtetësinë |
| ADRESA | `https://versus.al/aktualitet/denimet-ne-hage-reagon-kryediplomati-britanik-krenare-me-rolin-tone-n-i46657` |
| BURIMI | versus.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 15:02:14 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 14:39:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `b34df1cd0ebff4d312179b1aef0f879f2d1f21319602093d5f673c9c4849c38f` |
| TEKSTI | `a7f890a743d778ef2cce4a01eb51e256962c4279e1d6aaccdf3d9a7ae78cfbe9` |
| PAMJA | `e9ce64763de589da8be885d5579a90d770c42c625ed25621b1ddd0b11c18a05e` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `4a2d5f2452f55330a3f68c31357eba88831d18c63c701e5e64ad8e5ee713c35a` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `c11531ba0c325ce57cb42979570286028b15ce78f5f30478d991f53d7430dd86` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/4a2d5f2452f55330a3f68c31357eba88831d18c63c701e5e64ad8e5ee713c35a`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Live Updates

[Vendime tronditëse nga Haga, gjykata dënon me 81 vite burg 4 liderët e UÇK! Nga 25 vite burg për Thaçin e Krasniqin]

16 Shtator 2026, 09:40

^ekstrakti^



- Politikë
- aktualitet
- MAGAZInë
- bota
- opinion

- VIDEO

Created and monetized by
AKTUALITET / 16 Shtator 2026, 16:39

# Dënimet në Hagë, reagon kryediplomati britanik: Krenarë me rolin tonë në Kosovë vitin 1999. Vendimi i sotëm nuk është mbi shtetësinë

Ministri britanik e cilësoi Mbretërinë e Bashkuar si një mik dhe partner të afërt të Kosovës, duke riafirmuar mbështetjen për sovranitetin, pavarësinë dhe integritetin territorial të saj, si dhe për paqen në të gjithë Ballkanin Perëndimor

Shkruar nga Versus



Mbretëria e Bashkuar ka reaguar pas vendimeve dënuese të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

Ministri britanik për Evropën, Lord Wood i Anfieldit, deklaroi se Mbretëria e Bashkuar respekton pavarësinë e Gjykatës Speciale dhe procesin e saj gjyqësor, duke theksuar se Londra mbetet e përkushtuar ndaj drejtësisë, llogaridhënies dhe pajtimit në rajon.

Në reagimin e tij, ministri britanik e cilësoi Mbretërinë e Bashkuar si një mik dhe partner të afërt të Kosovës, duke riafirmuar mbështetjen për sovranitetin, pavarësinë dhe integritetin territorial të saj, si dhe për paqen në të gjithë Ballkanin Perëndimor.

"Ne jemi krenarë për rolin që luajtëm, së bashku me aleatët e NATO-s, në parandalimin e një katastrofe humanitare në vitin 1999 dhe në mbështetjen e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008", u shpreh Lord Wood.

"Mendimet e Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar janë me viktimat dhe familjet e tyre", tha më tej ministri britanik në reagimin publik.

Më tej, theksohet se "konstatimet e Gjykatës kanë të bëjnë me individë dhe nuk duhet të përdoren për të nxitur tensione ndërmjet komuniteteve apo në mbarë rajonin. Në këtë moment të rëndësishëm, udhëheqësit politikë dhe figurat publike kanë përgjegjësinë të promovojnë qetësinë, të sigurojnë që çdo reagim të mbetet paqësor dhe që siguria e njerëzve të jetë përparësia kryesore".

Mbretëria e Bashkuar, tha ministri Lord Wood, "do të vazhdojë të punojë me partnerët në rajon dhe më gjerë për të mbështetur paqen, drejtësinë dhe një të ardhme të sigurt e të begatë për të gjitha komunitetet"./**Versus.al**

Poll



AKTUALITET

### "Të ndaluarit mbaheshin pa ushqim dhe ujë, të lidhur me zinxhirë ose pranga", akuzat që rënduan 4 ish-krerët e UÇK-së në gjyqin e Hagës

16 Shtator 2026, 16:23

^ekstrakti^





AKTUALITET

["Albin hajde poshtë"/ Pas vendimit të Hagës, protestuesit thyejnë me gurë xhamat e ndërtesës së Qeverisë]()

16 Shtator 2026, 16:11

^ekstrakti^




AKTUALITET

[Reagimet pas vendimit të Hagës për 4 ish-krerët e UÇK-së, DASH thirrje Kosovës: Shmangni retorikën nxitëse, punoni për një të ardhme paqësore]()

16 Shtator 2026, 15:57

^ekstrakti^




AKTUALITET

[VIDEO/ "Hajdute"/ Pas Taulant Ballës, qytetarët i 'zënë pritë" në rrugë edhe deputetes Olta Xhaçka]()

16 Shtator 2026, 15:45

^ekstrakti^



AKTUALITET

**"Nuk tërhiqemi"/ Një ditë para shqyrtimit të pr.ligjit për pagat, reagon Gjykata e Lartë: Respektoni Kushtetutën!**

16 Shtator 2026, 15:22

^ekstrakti^



AKTUALITET

**Burgosja e ish-krerëve të UÇK-së, shpresat tek ndërhyrja e Trump ndaj Hagës, njësoj siç sanksionoi Gjykatën Penale Ndërkombëtare**

16 Shtator 2026, 14:56

^ekstrakti^



AKTUALITET

**700 euro për person nga Devolli në Tiranë, kapet i riu që transportonte 6 emigrantë sudanezë**

16 Shtator 2026, 09:23

^ekstrakti^



AKTUALITET

**Ndërmjetësi i drogës i Gerd Gjinararit u vu në përgjim. Policia e Antwerp informoi homologët shqiptarë për 41 kg kokainë të fshehur në kontejnerin e AMG Food**

15 Shtator 2026, 21:50

^ekstrakti^

**Të fundit**



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.